



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:016720

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06770066

C.nr.159/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoren profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditësve: A.S. nga Suhareka, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.Gj. nga Prizreni dhe B.S. nga Suhareka, të cilën me autorizim e përfaqëson av. G.Gj. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.Q. nga Prishtina, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 4,200.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të të autorizuarve të paditësve dhe të autorizuarit të të paditurës, më datë 13.01.2025 mori, ndërsa me datë 29.01.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.S. dhe B.S., që të dy nga Suhareka, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial.

II. DETYROHET e paditura, që paditësve, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 16.02.2020, t’ia paguajë shumat si në vijim:

- Paditësit A.S.

a). Dëmin jo material

- për dhimbje fizike, shumën prej.....200.00  
euro

- për frikë, shumën prej.....200.00  
euro

Në shumë të përgjithshme prej 400.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit (13.01.2025) deri në pagesën e plotë të shumës, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

b). Dëmin material

- për ndihmë të huaj, shumën prej.....200.00  
euro

- për ushqim të përforcuar, shumën prej.....300.00  
euro

- për fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit, shumën prej .....100.00  
euro

Në shumë të përgjithshme prej 600.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë (29.01.2021) deri në pagesën e plotë të shumës, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

- Padi tëses B.S.

a). Dëmin jo material

- për dhimbje fizike, shumën prej.....200.00 euro

- për frikë, shumën prej.....200.00 euro

Në shumë të përgjithshme prej 400.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit (13.01.2025) deri në pagesën e plotë të shumës, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

b). Dëmin material

- për ndihmë të huaj, shumën prej.....200.00 euro

- për ushqim të përforcuar, shumën prej.....300.00 euro

- për fitimin e humbur për shkak të paafësisë për punë gjatë kohës së mjekimit, shumën prej .....100.00 euro

Në shumë të përgjithshme prej 600.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë (29.01.2021) deri në pagesën e plotë të shumës, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që padi tësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, konkretisht padi tësit A.S. në shumën prej 235.05 euro dhe padi tëses B.S. në shumën prej 457.72 euro apo shumën e përgjithshme prej 692.77 euro, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pabazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadi së padi tësve, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 4,200.00 euro, përkatësisht shuma prej 2,200.00 euro, konkretisht për shpenzimet e mjekimit shuma prej 1,000.00 euro, për secilin padi tës dhe në emër të stresit të mos përqendrimit shuma prej 100.00 euro, për secilin padi tës.

## A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Padi tësit A.S. nga Suhareka, përmes të autorizuarit të tij av.B.Gj. nga Prizreni, si dhe padi tësja B.S. nga Suhareka, përmes të autorizuarit të saj av.G.Gj. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka

parashtruar padinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.Q. nga Prishtina, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 4,200.00 euro.

Në padi, është theksuar se më datë 16.02.2020, rreth orës 17:44, në rrugën “Bazhdarhane” Prizren, si pasojë e mos kontrollimit të shpejtësisë së veturës me targa ..... vetura përplas me shpejtësi nga mbrapa palën paditëse A.S. me ç’rast të njëjtit i shkaktonte lëndim serioz trupor dhe dëm të konsiderueshëm material në këtë aksident pala paditëse në ulësen e parme të veturës kishte edhe nënën e tij B.S. si pasagjere. Pasi që dalin autoritetet policore në vend të ngjarjes për të shikuar rastin dhe shkaktuesin e aksidentit fajtor e konstatojnë dhe e gjejnë personin i cili nga mbrapa e ka goditur me veturë paditësin. Po ashtu, shkaktuesi i aksidentit e ka pranuar fajësinë andaj është dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.473/20. Paditësit kanë marrë lëndime trupore të qafës, kokës, gjatë aksidentit, janë mjekuar dhe kanë shkaktuar shpenzime. Andaj, i kanë propozuar gjykatës që të aprovojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, duke e obliguar palën e paditur që të i kompensojë paditësve për dëmet e pësuar, me kamat ligjore prej 8%, si dhe të detyrohet e paditura që t’ia paguaj shpenzimet e procedurës paditësve.

Gjykata me aktvendimin C.nr.159/2021 të datës 01.09.2023, e ka detyruar të paditurën për përgjigje në padi duke ja dërguar të njëjtin si dhe padinë me provat e tjera, përkundër faktit se e paditura me datë 07.09.2023, e ka pranuar aktvendimin nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Gjykata bazuar në nenin 411.1 të LPK-së, lëndën C.nr.159/21 me të gjitha shkresat e saj, e ka dërguar në procedurën e ndërmjetësimit për arritjen e marrëveshjes eventuale, mirëpo nga ndërmjetësuesi është njoftuar përmes raportit se palët ndërgjyqëse nuk kanë përfillur raportin e ndërmjetësimit, ashtu që lënda është kthyer përsëri në procedim të mëtejshëm në procedurën kontestimore.

Me parashtrësën e datës 06.11.2024, i autorizuari i paditësit A.S. ka precizuar- ndryshuar padinë në aspektin objektiv, ashtu që ka kërkuar të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,100.00 euro. Si dhe me parashtrësën e datës 06.11.2024, i autorizuari i paditëses B.S. ka precizuar- ndryshuar padinë në aspektin objektiv, ashtu që ka kërkuar të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,100.00 euro.

Gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit A.S. ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe precizimit të datës 06.11.2024. Pas administrimit të provave pa mëdyshje është vërtetuar bazueshmëria e kërkesës të palës paditëse në çështjen e kompensimit të dëmit duke vlerësuar se edhe ekspertiza e lëmit ortopedike dhe ekspertiza psikiatrike në mendimin e tyre kanë dhënë sqarime se pala paditëse ka lëndime serioze andaj gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit të aprovon kërkesëpadinë si të bazuar të palës paditëse, po ashtu ka kërkuar shpenzimet e përcaktuara sipas tarifave të Odës së avokatëve.

Gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditëses B.S. ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe precizimit të datës 06.11.2024. Nga provat të cilat janë administruar gjatë këtij procesi gjyqësor, veçanti nga raporti i ortopedisë dhe nga ekspertiza psikiatrike, pa mëdyshje me këto raporte është vërtetuar dëmi i shkaktuar dhe pasojat të cilat i kanë bartur palët këtu B.S. andaj pas dhënies së fjalës

përfundimtare presim nga gjykata që të nxjerr aktgjykimin meritore ku palën të cilin e përfaqësojë do ti akordohet shuma përkatëse në proporcion me lëndimet dhe pasojat të cilat i ka marrë, njëherit i ka kërkuar shpenzimet procedurale të përfaqësimit të avokatit sipas regjistrimit të tarifave të Odës së avokatëve.

I autorizuari i të paditurës, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, për të paditurën nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve për sa i përket përgjegjësisë në shkaktimin e aksidentit ndërsa jashtë seancës kemi ofruar vlerën nga 1200 euro, për secilin paditës dhe e njëjta nuk është pranuar. I njëjti e ka kundërshtuar edhe precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv, për shkak se një kërkesë e tillë është tejet e lartë dhe nuk është në proporcion me shkallët e lëndimeve e as në mendimin e dhënë nga ana e ekspertëve mjekësorë. Bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke marrë për bazë shkallët e lëndimeve të dhëna nga ekspertët mjekësorë, ka konsideruar se ofertat e dhënë për A.S. dhe B.S. që të dyja në vlerë prej 1.300 €, është në harmoni me shkallën e lëndimeve, andaj gjykatës i ka propozuar që përtej kësaj oferte pjesën tjetër të kërkesë padisë të refuzoj si të pabazuar. Sa i përket kamatës gjykatës i ka propozuar që të rrjedh nga dita e marrjes së aktgjykimimit kjo e mbështetur në dispozitat ligjore dhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykatës i ka propozuar që të vendosë në bazë të nenit 452 të LPK-së paragrafi 2.

#### Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: ekspertizën mjeko ligjore ortopedike-traumatologjike të datës 28.08.2024, punuar nga Dr. I.S. nga Prizreni; ekspertizën psikiatrike të datës 28.08.2024, punuar nga Dr. N.F. nga Prizreni; vendimin numër 00288/TPL/20/JM04 i datës 24.08.2020; raportin specialistik numër protokollit 1481 i datës 16.02.2020, për paditësen B.S. raportin e aksidentit numër 2020/GR/0087 i datës 16.02.2020; raportin nga konsullata për paditësin A.S. i datës 16.02.2020; raportin specialistik numër protokollit 1482 i datës 16.02.2020, për paditësin A.S. si dhe aktgjykimin P.nr.473/20 i datës 20.10.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

- kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Nga leximi i ekspertizës mjeko ligjore ortopedike-traumatologjike e datës 28.08.2024, punuar nga Dr. I.S. vërtetohet se paditësi A.S. si pasojë e aksidentit të trafikut ka pësuar ndrydhje të qafës dhe kokës, i cili lëndim karakterizohet si lëndim i lehtë trupor, i cili ka shkaktuar dhimbje fizike, të intensitetit posaçërisht të rëndë 20 min., të intensitetit të rëndë 24 orë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes), të intensitetit të mesëm 14 ditë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate), si dhe të intensitetit të lehtë 1 muaj. Gjithashtu nga ekspertiza vërtetohet se, shëmtim trupor nuk ka, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka. Sa i përket ndihmës së personit tjetër, ka qenë e nevojshme për 14 ditë, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 21 ditë, në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, minerale dhe vitamina, si dhe rehabilitimi fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm për 10 seanca fizioterapie. Ndërsa sa i përket paditësës B.S. nga ekspertiza gjykata ka vërtetuar se e njëjta si pasojë e aksidentit të trafikut ka pësuar lëndime, ndrydhje qafe dhe ndrydhje të supit të

majtë, të cilat karakterizohen si lëndime të lehta trupore, të cilat i kanë shkaktuar dhimbje fizike, të intensitetit posaçërisht të rëndë 20 min., të intensitetit të rëndë 24 orë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes), të intensitetit të mesëm 14 ditë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate), si dhe të intensitetit të lehtë 2 muaj. Gjithashtu nga ekspertiza vërtetohet se, shëmtim trupor nuk ka, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka. Sa i përket ndihmës së personit tjetër, ka qenë e nevojshme për 14 ditë, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 21 ditë, në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, minerale dhe vitamina, si dhe rehabilitimi fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm për 20 seanca fizioterapie, 10 për qaf dhe 10 për sup.

Nga leximi i ekspertizës psikiatrike të datës 28.08.2024, punuar nga Dr. N.F.- psikiatër, është vërtetuar se paditësi A.S. në aksidentin e trafikut të datës 16.02.2020, ka përjetuar frikë sekondare, për shkak se goditja nga mbrapa e makinës e pamundëson perceptimin direkt të rrezikut fatal për veten dhe me këtë përjetimin e frikës primare. Ndërsa ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm dy javë, si dhe frikë sekondare me intensitet të ulët, që ka vazhduar rreth 12 muaj. Sa i përket paditëses B.S. nga ekspertiza është vërtetuar se e njëjta në aksidentin e lartëpërmendur, ka përjetuar frikë sekondarë, për shkak se goditja nga mbrapa e makinës e pamundëson perceptimin direkt të rrezikut fatal për veten dhe me këtë përjetimin e frikës primare. Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm dy javë, si dhe frikë sekondare me intensitet të ulët, që ka vazhduar rreth 12 muaj.

Nga leximi i vendimit numër 00288/TPL/20/JM04 të datës 24.08.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu e paditura kompania e sigurimeve “Sigal”, në procedurë jashtë gjyqësore, e ka miratuar kërkesë e këtu paditësit A.S. në shumën prej 650.00 euro, për kompensimin e dëmit jo material (shëndetësor) dhe material të pësuar si pasojë e aksidentit të datës 16.02.2020.

Nga leximi i raportit specialistik numër protokolli 1481 të datës 16.02.2020, për paditësen B.S. gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjta po ditën e aksidentit ka marrë trajtim mjekësor pranë Emergjencës së Spitalit Rajonal të Prizrenit Prim.Dr.Daut Mustafa.

Nga leximi i raportit të aksidentit numër 2020/GR/0087 të datës 16.02.2020, u vërtetua se me datë 16.02.2020, rreth orës 17:40, deri te aksidenti i komunikacionit, kishte ardhur kur vozitësi A.M. ishte duke drejtuar automjetin dhe ishte duke lëvizur në shiritin e majtë të rrugës “Rrust Kabashi”, në drejtim të rrugës “Adem Jashari”, me të arritur përball market “Korabi”, vozitësi si pasojë e vozitjes së rrezikshme del jashtë cepit të majtë të rrugës dhe me anën e majtë të veturës e godet një shtyllë elektrike ndriçuese e cila gjatë rënies në rrugë e godet këmbësin B.S. i cili ishte duke kaluar në vendkalimin e shënuar për këmbësor, pastaj vetura bartet dhe me këndin e pasmë të anës së majtë të veturës e godet në pjesën e pasme të veturës së paditësit, pas goditjes me këtë veturë, vetura e drejtuar nga A.M. me mesin e anës së majtë e godet edhe një shtyllë tjetër elektrike dhe përfundimisht vetura ndalet në rreth rrotullim. Si pasojë e këtij aksidenti në veturat e aksidentuara janë shkaktuar dëme materiale të mëdha ndërsa lëndime kanë pësuar vozitësit e veturave të aksidentuara si dhe pasagjerët e tyre.

Nga leximi i raportit nga konsullata për paditësin A.S. i datës 16.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se, paditësi A.S. pas aksidentit i është nënshtruar trajtimit mjekësor, pranë specialistit të mjekësisë familjare në Prizren.

Nga leximi i raportit specialistik numër protokolli 1482 i datës 16.02.2020, për paditësin A.S. gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti po ditën e aksidentit ka marrë trajtim mjekësor pranë Emergjencës së Spitalit Rajonal të Prizrenit Prim.Dr.Daut Mustafa.

Nga leximi i aktgjykimit P.nr.473/20 të datës 20.10.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, e ka shpallur fajtor të pandehurin A.M. për shkak se me datë 16.02.2020 rreth orës 17:40 min., në rrugën “Rrust Kabashi”, duke drejtuar automjetin e tij në mënyrë të pakujdesshme dhe në kundërshtim me nenet 53 dhe 149 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, ashtu që i njëjti ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr..06/L-074. Gjithashtu u vërtetua se të dëmtuarit A.S. dhe B.S. këtu paditësit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

## Baza ligjore

Me nenin 136 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr.04/L-077 (LMD), është paraparë se “kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”. Pastaj, sipas nenit 140 të LMD-së shprehimisht përcaktohet që “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”.

Më konkretisht, me nenin 159 par. 1 të LMD- parashihet që “në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”. Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit të theksuar të LMD-së thuhet se “në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotërues i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre”.

Më tutje, sipas nenit 169 par. 1 të LMD-së shprehimisht përcaktohet që “personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëm”. Pastaj, në paragrafin 3 të këtij neni thuhet se “kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit”. Ndërsa, sipas paragrafit 4 të nenit 169 theksohet që “gjykata do t’i gjejë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme”.

Me nenin 179 par. 1 të LMD-së parashihet se “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”. Pastaj, neni 183 par. 1 i LMD-së përcakton që “për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjejë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni të LMD-së parasheh se “me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për

atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Pastaj, me Ligjin nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, në nenin 10 përcaktohet që “kompensimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”.

Ndërsa, me nenin 7 par. 1 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Me nenin 2 par. 2 të LPK-së është paraparë se “gjkata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.

### Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në këtë drejtim, gjykata pas vlerësimit të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor, të propozuara nga pala paditëse dhe ajo e paditur, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, lidhur me aksidentin e komunikacionit të datës 16.02.2020.

Kontestuese në këtë çështje juridike kontestuese ishte lartësia e dëmit material dhe jo material që paditësve i është shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 16.02.2020 dhe shuma përkatëse që paditësve iu takon në emër të kompensimit të këtij dëmi.

Në këtë drejtim, duke marrë parasysh se në këtë çështje juridike kontestuese ishte vetëm lartësia e kërkesës dhe nga rrethanat e rastit konkret, sidomos ekspertizës mjekësore të Dr. I.S.- ortoped-traumatolog dhe ekspertizës psikiatrike të nga Dr. N.F.- psikiatër, gjykata vërtetoi se paditësit A.S. dhe B.S. nga aksidenti i ndodhur më datën 16.02.2020, kanë pësuar dëmtime të lehta trupore, fakt i cili më saktësisht provohet nga ekspertiza mjekësore e Dr. I.S. e datës 28.08.2024. Nga kjo ekspertizë, po ashtu është vërtetuar se paditësit si pasojë e aksidentit të datës 16.02.2020 kanë përjetuar dhimbje fizike me intensitet të lartë, dhimbje fizike me intensitet të mesëm dhe dhimbje fizike me intensitet të ulët. Pastaj, nga ekspertiza psikiatrike e Dr. N.F.- psikiatër e datës 28.08.2024, vërtetohet se paditësit kanë përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët. Andaj, ashtu siç është deklaruar nga ekspertët mjekësor përmes ekspertizave të lartcekura, paditësve iu takon e drejta e kompensimit të dëmit jo material, që mund të jetë një formë e satisfaksionit moral për paditësit, e që kanë të bëjnë me dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, bazuar edhe në provat materiale të ofruara nga pala paditëse, përkatësisht nga raportet mjekësore dhe dokumentacioni tjetër mjekësor i prezantuar nga paditësit, por edhe të dëmit material sipas saktësimeve në ekspertizën mjekësore.

Mbi këto fakte dhe arsye, gjykata ka aprovuar shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që të njëjtat janë adekuate dhe të drejta, kjo duke u bazuar në lëndimet e pësuar nga paditësit si pasojë e aksidentit të shkaktuar. Kështu, ekspertët përkatës kanë vlerësuar se lëndimet e paditësve janë lëndime të cilat karakterizohen si lëndime të karakterit të lehtë trupor. Andaj, lartësia e shumës së gjykuar në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarve- paditësve satisfaksion që ata të jenë në gjendje t'i kompensojnë të mirat jomateriale dhe materiale nga të

cilat janë privuar. Më saktësisht, sa i përket shumave lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial, janë marrë parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve fizike, frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe të gjitha lëndimeve tjera të përshkruara më hollësisht në ekspertizat e ekspertëve përkatës, të cilat janë përmendur më lartë, të cilave gjykata ia fali besimin e plotë. Kësisoj, gjykata ka pasur parasysh vendin në të cilin janë lënduar paditësit dhe atë paditësi A.S. në pjesën e qafës dhe të okës, ndërsa paditësja B.S. në pjesën e qafës dhe të supit të majtë, të cilat përcillen me dhimbje fizike deri në mjekim e shërim, vështirësitë dhe shqetësimet me rastin e mjekimit dhe me këtë rast ka caktuar shumat sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Pra, në rastin konkret gjykata i vlerësoi të gjitha provat, e sidomos ekspertizat e bëra nga ana e mjekëve përkatës- ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë, sipas të cilave prova gjykata erdhi në përfundim se shumat e aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të gjitha llojet e dëmit të shkaktuar me rastin e aksidentit të komunikacionit, janë të përshtatshme dhe në përputhje me natyrën e lëndimeve të paditësit. Po ashtu, me rastin e gjykimit të formave të dëmit jo material, gjykata ka pasur parasysh edhe kriteret e orientuese, sipas Udhëzuesit për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jomaterial nr. 41/2023 i datës 27.02.2023. Kështu, gjykata ka gjykuar shumë prej 200.00 euro për dhimbje fizike dhe shumë prej 200.00 euro për frikë, në shumë e përgjithshme prej 400.00 euro, për secilin paditës, pra ka aprovuar në tërësi kërkesën e paditësve për këto kategori të dëmit. Andaj, gjykata vlerëson se në përputhje me nenin 183 par. 2 të LMD-së, shpërblimi i dëmit jo material dhe lartësia e shpërblimit të tij, janë në përputhje me rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, dhe se me këtë shpërblim nuk favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e tij dhe me qëllimin shoqëror.

Në anën tjetër, sa i përket shumave të gjykuara për kompensimin e dëmit material për paditësit, në emër të përkujdesjes së personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, kjo gjykatë i vlerëson si të pranueshme dhe në mbështetje edhe në ekspertizën mjekësore të ortopedisë- traumatologjisë. Kështu, duke marrë për bazë kohëzgjatjen e nevojës për përkujdesjen e personit të tretë për periudhën kohore prej 14 ditësh, dhe ushqimin e përforcuar për 21 ditë, të konstatuar në ekspertizë mjekësore për paditësit, si dhe faktin që praktika gjyqësore i njeh rastet e tilla të kompensimit, gjykata i gjykoi në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar, të njëjtit ligjërisht i takon ky lloj kompensimi i dëmit të kërkuar, të cilat në shumë konkrete gjykata i ka aprovuar në tërësi sipas kërkesës së paditësve, dhe atë për ndihmën e huaj shumë prej 200 euro, ndërsa për ushqimin e përforcuar shumë prej 300 euro, për secilin paditës, respektivisht nevojës. Gjukata vlerësoi se për shkak të lëndimeve të pësuar trupore dhe trajtimit mjekësor që paditësit i janë nënshtruar, ato ditë nuk kanë mundur të punojnë andaj, iu takon fitimi i humbur në emër të paafësisë së përkohshme në punë, dhe atë në shumë prej 100.00 euro, për secilin paditës, kërkesa e aprovuar në tërësinë e saj. Gjukata konstaton se bazuar në raportin e mjekëve që paditësit kanë pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 14 ditësh, rrjedhimisht i bie që në këtë periudhë kohore të njëjtit nuk kanë mundur të zhvillojnë aktivitetin e tyre punues, andaj edhe iu takon se drejta e fitimit që ka mundur të realizohej po të mos ishte shkaktuar dëmi, andaj shuma prej 100.00 euro për secilin paditës është ekuivalente me rrethanat se rastit. Përkatësisht, të gjitha format e theksuara të dëmit material gjykata i vlerësoi në shumë e përgjithshme prej 600.00 euro.



Së këndejmi, gjykata vendosi sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit në përputhje me nenin 159, 169, 179 dhe 183 të LMD-së.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e marrjes së aktgjykimit më datë 13.01.2025, për dëmin jomaterial, si dhe nga dita e parashtrimit të padisë me datë 29.01.2021 për dëmin material, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht të kërkesës për shpërblim të dëmit jomaterial në emër të stresit të mos përqendrimit në shumë prej 100.00 euro, për secilin paditës, dhe dëmit material në emër të shpenzimeve mjekësore shumë prej 1,000.00 euro për secilin paditës, gjykata i refuzoi si të pabazuara si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket kërkesës për shpërblim dëmi në emër të stresit të mospërqendrimit, gjykata vlerësoi se kjo formë e dëmit nuk është e përcaktuar në asnjë dispozitë ligjore të LMD-së, si lex specialis, andaj një kërkesë të tillë për këtë formë dëmi të pa kategorizuar, gjykata e refuzoi si të pa bazuar. Ndërsa sa i përket kërkesës për shpërblimin e dëmit material në emër të shpenzimeve të mjekimit, gjykata e refuzoi si të pa bazuar në tërësinë e tij, për shkak se paditësit me asnjë provë të vetme nuk ia kanë bërë të besueshme gjykatës kërkesën e tyre, përkatësisht të njëjtit nuk kanë dorëzuar asnjë faturë pagese për shpenzimet e mjekimit, andaj derisa një kërkesë e tillë nuk bazohet në prova materiale, për gjykatën është e pa provuar andaj u refuzua si e pa bazuar. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit, është marrë konform nenit 449 dhe 452 par. 2 lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës paditësve, në shumë të përgjithshme prej 692.77 euro apo paditësit A.S. në shumë prej 235.05 euro dhe paditëses B.S. në shumë prej 457.72 euro, nga shuma prej 1,454.80 euro sa kishte kërkuar pala paditëse. Kështu, duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur, nenin 452 par. 2 të LPK-së, pasi që paditësit kanë pasur sukses vetëm pjesërisht në kërkesën e paraqitur, përkatësisht në nivel prej 47.62 %, dhe mbi këtë bazë gjykata vendosi që paditësve i takojnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 692.77 euro, mbi bazën e suksesit të tyre në këtë kontest, përkatësisht vetëm në nivelin e suksesit lidhur me kërkesëpadinë. Më konkretisht, me rastin e llogaritjes së shpenzimeve të palës paditëse, gjykata mori parasysh pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësve, në raport me kërkesën e parashtruar në kërkesëpadi- precizim, duke e aplikuar këtë metodë edhe lidhur me shpenzimet procedurale. Pra, shuma e kërkuar e shpenzimeve procedurale nga pala paditëse është në shumë prej 1,454.80 euro, ndërsa niveli i përqindjes së suksesit në procedurë, përkatësisht e drejta shpenzimeve të paditësve është gjithsej në shumë prej 692.77euro.

Duke u bazuar në arsyet dhe faktet e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në përputhje me dispozitat ligjore të theksuara në arsyetim të aktgjykimit dhe nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.159/2021, më datë 13.01.2025

Numri i lëndës: 2021:016720  
Datë: 29.01.2025  
Numri i dokumentit: 06770066

Gjyqtari  
Uran Zogaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.